



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 165, datë 03.04.2024

**PËR
PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL VITI KALENDARIK 2021, PËR GJYQTARIN MARKELIAN
KOÇA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” dhe atë nr. 595, datë 26.11.2020, me propozim të relatores së çështjes znj. Yllka Rupa,

VENDOSI:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarin Markelian Koça, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 121 datë 06.03.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Viti kalendarik 2021 do të përfshihet në periudhën 5/vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.
3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. Markelian Koça, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR